

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Peticion ndërkombëtar shkencor për ruajtjen e deltës së Vjosës - Citizens.al
ADRESA	https://citizens.al/2026/08/03/peticion-nderkombetar-shkencor-per-ruajtjen-e-deltës-se-vjoses/
BURIMI	citizens-channel.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 21:44:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	3 gusht 2026, 14:44:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1848603241f14bf1a5e47172b23bc4d1538a9e51d45f5498f733b42dc26059b0
TEKSTI	fd8da9aa74c07d472d87b3fd128df40f5339af59388e48941f04f78909c8155f
PAMJA	35abc17c614606ba64db5675213ec14fe7091e8af52b12bcdff5e394dcb0f2ef

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	04e5e68bfb56e148556c616d412d6b22acdd865ff575a949bcb4e7f968184f14
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3fbe5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmPnNf1qdmUZ7ZGmyYMWfEMaR1a5zbCFQKNxYmATJxZLPp



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/04e5e68bfb56e148556c616d412d6b22acdd865ff575a949bcb4e7f968184f14>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Peticion ndërkombëtar shkencor për ruajtjen e deltës së Vjosës



Autor: Citizens.al

August 3, 2026



Foto ilustrim/Citizens.al

Nga Prof. Aleko Miho, Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

Në emër të një grupimi ndërkombëtar prej 534 shkencëtarësh nga 32 vende, po ndaj me publikun e gjerë peticionin ndërkombëtar shkencor me titull: "Thirrje për Ruajtjen Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Deltës së Vjosës" (Korrik 2026).

Komuniteti shkencor është i shqetësuar dhe i alarmuar nga planet për ta shndërruar Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë në një qendër të turizmit masiv komercial. Delta e Vjosës, me lagunat e saj brendetare, nuk është vetëm një nga deltat e fundit të paprekura dhe me ekosistem aktiv përgjatë gjithë bregdetit mesdhetar, por edhe një pasuri ekologjike me rëndësi evropiane dhe një nyje kritike përgjatë Korridorit të Migrimit të Adriatikut. Kjo deltë strehon 35 lloje habitatesh të përfshira në Direktivën Natura 2000 dhe klasifikimin EUNIS – ku 8 prej tyre klasifikohen si habitate prioritare të BE-së; mes tyre vlen të përmendet se 40% e zonës përbëhet nga zona ligatinore, kryesisht laguna dhe kënetat, e cila klasifikohet si habitat prioritar.



Pamje ajrore e Deltës së Vjosës gjatë Javës së Dytë Shkencore 22-27 Prill 2024 (© Joshua D. Lim).

Zona strehon mbi 2,500 lloje të njohura gjallesash, mbi 750 lloje bimore, mbi 580 lloje algash, rreth 670 lloje invertebrorësh ujorë dhe tokësorë, dhe rreth 490 lloje vertebrorësh, ndër të cilët rreth 250 lloje shpendësh mbi 100 lloje peshqish. Zonat ligatinore strehojnë mbi 60 lloje shpendësh ujorë me rreth 20,300 individë që dimërojnë aty. Rreth 280 lloje gjallesash janë të kërcënuara në nivel ndërkombëtar, ndërsa mbi 220 lloje janë të kërcënuara në Shqipëri. Mes tyre janë rreth 130 lloje shpendësh dhe 100 lloje bimësh që janë pjesë e listave ndërkombëtare të mbrojtjes. Të gjitha këto rrezikohen nga degradimi i rëndë ose shkatërrimi i plotë nëse këto plane zhvillimi vihen në zbatim, përfshirë dhe habitatet prioritare.

Zona njihet si Hapësirë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) nga BirdLife International (2026). Dhe si Hapësirë e Rëndësishme për Bimët (IPA) (kodi A35). Zona është gjithashtu kandidate për t'u përfshirë në rritin e BE-së. Natura 2000. Lideni Limonuo. Dunat Zvërnec-

Të Fundit




14 protestuesit lirohen pa masë sigurie, arrestimi shpallet i paligjshëm

4 September 2026 0



Llogaritë e mbyllura në Instagram, Rama mohon përfshirjen; EDP kërkon...

4 September 2026 0



Zërat e 'Revolucionit Flamingo' në Instagram sulmohen në të njëjtën...

3 September 2026 0



"Pasqyrë Albania": një premtim, pesë emra, 13 vjet

3 September 2026 0



Kulla të 'Zyber Hallulli': gjykata urdhëron hetim, KISH firmos kontratën tr...

3 September 2026 0



Aleança për

Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

Akërnë, Pylli në Ishullin e Zvërnecit dhe Kodrat Molasike të Zvërnecit, janë të katërta në listën e Monumenteve të Natyrës Shqiptare (Kategoria III e mbrojtjes; VKM 303/2019).



Pamje e Monumenteve të Natyrës (Kategoria III e mbrojtjes sipas kriterëve të IUCN) brenda hapësirës së Peizazhit të Mbrojtur Pishë Poro–Nartë: Liqeni Limopuo lake (a); Dunat e Zvërnecit-Akërnës (b&c); Kodrat Molasike të Zvërnecit (d); dhe Pylli i Ishullit të Zvërnecit (e).

Ndër firmëtarët ka ekologë peizazhi me përvojë për ujërat e ëmbla dhe ato detare, të cilët paralajmërojnë për dëme të pakthyeshme në habitatet e mbrojtura nga zhvillimet e propozuara në shkallë të gjerë të turizmit. Vendosja e infrastrukturës luksoze në këtë vend të shenjtë do të përbënte shkelje të drejtpërdrejtë të statusit ligjor mbrojtës të këtij peizazhi bregdetar dhe do të shkelte angazhimet e Shqipërisë sipas akteve ndërkombëtare.

Peticioni u është dërguar dje gjithë përfaqësuesve kryesorë të qeverisë shqiptare dhe atyre ndërkombëtare (KM: Rama; BE: Von der Leyen; DG ENEST; DG ENV; Konventës së Bernës; UNESCO MAB; etj.). Në mënyrë shumë qytetare u kërkohet të gjitha palëve të njihen me Peticionin dhe të angazhohen së bashku me Qeverinë shqiptare për: 1) Anulimin e projekteve tregtare shkatërruese brenda Deltës së Vjosës. 2) Integrimin e plotë të Deltës në Parkun Kombëtar ekzistues të Vjosës si Lumë i Egër. 3) Miratimin e një strategjie të qëndrueshme ekoturizmi, në harmoni me natyrën. Nga ana jonë mirëpresim mundësinë për t'i diskutuar më tej këto gjetje shkencore me gjithë palët.

Ndërsa Shqipëria përparon në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ne i kërkojmë Komisionit Evropian të sigurojë që standardet e mbrojtjes së mjedisit, konkretisht Direktivat e BE-së për Shpendët dhe Habitatet, të mbështeten sipas Kapitullit 27. Zhvillimet tregtare të kësaj shkalle brenda zonave të mbrojtura ligjërisht bien ndesh me harmonizimin e BE-së dhe pasqyrojnë shqetësimet e ngritura në rezolutën e Parlamentit Evropian të qershorit 2026, e cila bënte thirrje për ngrirjen e ndërtimeve në zonat e mbrojtura të Shqipërisë.

Sekretariati i Konventës së Bernës bën me dije se e ka të hapur dosjen për çështjen e Deltës së Vjosës prej vitit 2016 (Ankesa Nr. 2016/05) mbi ndikimin e mundshëm negativ të zhvillimeve për lumin Vjosë, përfshirë ndërtimin e hidrocentraleve dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës. Në dy mbledhjet e fundit, Byroja e Komitetit të Përhershëm të Konventës u ka kushtuar vëmendje edhe zhvillimeve më të fundit.

Prej shtatorit 2025, Lugina e Vjosës është shpallur zyrtarisht si Rezervë e Njeriut dhe Biosferës së UNESCO-s; një vend i shenjtë që përfshin pjesë kyçe të deltës. Projektet e propozuara të turizmit luksoz e kërcënojnë drejtpërdrejt këtë rezervë të UNESCO-s, duke rrezikuar edhe zonën e saj qendrore të mbrojtur në mënyrë strikte. Parimet e Programit të Njeriut dhe Biosferës së UNESCO-s (MAB) tregojnë se ruajtja ekologjike dhe zhvillimi i komunitetit duhet të shkojnë dorë për dorë. Zhvillimet aktuale në Deltën e Vjosës i shkelin këto parime duke zëvendësuar ekosistemet delikate bregdetare me infrastrukturë të rëndë.

Ndërkohë Shqipëria ka rreth 2 muaj që është përfshirë nga një Protestë qytetare, ku ndërhyrjet në Deltën e Vjosës ishin shkaku i parë, dhe vazhdojnë të mbeten frymëzim që mban përditë gjallë shpirtin e qytetarëve në Bulevard.

Kjo është një arsye më shumë, madje shumë e fortë, që duhet të bëjë që Qeveria Shqiptare të reflektojë pozitivisht, por edhe gjithë instancat e tjera ndërkombëtare të bashkëpunojnë me Shqipërinë për ta ndihmuar të dalë nga kjo gjendje dhe të ndjekë rrugën e duhur në përputhje me gjithë standardet ndërkombëtare.

Peticioni i plotë: [Thirrje për Ruajtjen Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Deltës së Vjosës](#)



< PRAPA
Pesë vite afat për Ohrin: UNESCO paralajmëron se degradimi n...

PARA >
Harta e re territoriale ndëz protestat në Shqipëri

One Response



Suzana Rubiku says:

Mbrojtja e natyres është detyrë.
Shqipëria është e Jona.

Reply

4 August 2026 at 20:44

Leave a Reply

Your email address will not be published. Required fields are marked *

Comment *


Name *

Email *

Website

Post Comment

Te ngjajshme



14 protestuesit lirohen pa masë sigurie, arrestimi shpallet i paligjshëm

4 September 2026 0

Mëngjesin e 4 shtatorit, në ditën e 97-të të protestave të përditshme, dhjetëra qytetarë u mbledhën para Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pritje të ...



Citizens Channel është një media që ka për qëllim të promovojë zhvillimin e gazetarisë qytetare në Shqipëri dhe të fuqizojë zëra të përgjegjshëm, në përputhje me vlerat e një shoqërie gjithë pranuese dhe tolerante, në respektim të lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.